

Data 27.06.2024

**PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROCEDURËS:**

*“Shërbim për mbikëqyrjen e punimeve të zbatimit për nevojat e KESH sh.a”.*

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):**

Mbikëqyrja e punës së ndërtimit - 71247000-1

**VLERA E FONDIT LIMIT:**

**40,000,000 (Dyzetë milion) Lekë, pa TVSH**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Korporata Elektroenergjitike Shqiptare, KESH sh.a ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3;
- b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas shtojcës 9.

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 82 dhe 83 të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, si dhe nenet 26 dhe 30 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Në Nenin 82, të LPP-së citohet “1. *Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet Kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetë deklarimit, sipas*

*parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.*

Në Nenin 83 të LPP-së citohet: *“Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”*,

## **2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

### **2.1. Përshatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):**

me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetë deklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 9.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP i ndryshuar, nenit 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

### **2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**2.2.1** Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore të 3 (tre) viteve të fundit financiare ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit.

***Kërkesa e mësipërme konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar.***

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP i ndryshuar, si dhe nenin 43 pika 2/b , të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vlera e xhiros është kërkuar bazuar në nenin 43 pika 2/b , të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar në të cilin citohet: *2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:b) vlerën e përlllogaritur të kontratës ose lotit , në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar;*

---

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në dispozitat e legjislacionit Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar. VKM-së nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike".

Duke marrë në konsideratë specifikën e objektit procedure prokurimi, kërkohet që Operatorët Ekonomik ofertues të paraqesin vërtetime të cilat vërtetojnë se disponon kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare për të realizuar këtë procedurë prokurimi.

### **2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:**

**2.3.1** Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbime të mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës në një vlerë jo më të vogël se 40% e vlerës së fondit limit të kësaj kontrate.

*Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:*

- a) Për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" i ndryshuar dhe nenit 41, pika të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

---

**2.3.2** Operatori Ekonomik ofertues duhet të paraqesë Liçencën e Shoqërisë për mbikqyrje punimesh zbatimi në ndërtim, të lëshuar nga institucionet e autorizuara me ligj, në kategoritë si më poshtë:

### **I. PUNIME TË PËRGJITHSHME NDËRTIMI**

NP - 1 Punime gërmimi në tokë.

NP - 2 Ndërtime civile dhe industriale

NP -3 Rikonstrukcion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasada

NP - 4 Rrugë autostrada, ura, mbikalime, hekurudha, linja tramvaji, metro, hekurudhë me kavo dhe pista aeroportuale.

NP - 5 Punime nëntokësore, ura e vepra arti

NP – 6/b Diga të vogla (diga me lartësi deri 10 m ose me vëllim uji të grumbulluar deri 1 milion m<sup>3</sup> ose gjatësi kurore dige deri 500 ml)

NP -7/a Ujësjiellës, kanalizime, vepra kullimi e vaditje

NP -8 Ndërtime detare dhe punime thellimi në ujë

NP - 9 Punime dhe mbrojtje lumore sistemime hidraulike dhe bonifikime.

NP-11 Ndërtime për nënstacione, kabinat e transformacionit linjat e tensionit të lartë dhe tensionit të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë elektrike

NP -12 Punime të inxhinierisë së mjedisit.

## **II. PUNIME SPECIALE NDËRTIMI**

NS - 1 Punime për prishjen e ndërtimeve.

NS - 2 Impiante hidro-termosanitare dhe mirëmbajtja e tyre

NS- 3 Impiante ngritëse dhe transportuese (ashensorë, shkallë lëvizëse, transportues)

NS - 4 Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastike, metalike dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtuese

NS - 6 Sinjalistika rrugore jondriçuese

NS - 7 Barriera dhe mbrojtje rrugore

NS - 9 Punime strukturore speciale.

NS - 12 Impiante teknologjike, termike dhe të kondicionimit

NS - 13 Impiante dhe linja telefonie dhe telekomunikacioni

NS - 14 Impiante të brendshme elektrike, telefonike, radiotelefoni TV

NS-15 Pastrimi i ujërave detarë, liqenorë dhe lumorë

NS - 18 Punime topogjeodezike.

NS - 20 Shpime gjeologjiko-inxhinierike, puse e shpime për ujë.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenin 41, pika 4, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar si dhe vendimin nr.759, datë 12.11.2014 të Këshillit të Ministrave, “Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikqyrjes e koaludimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, ndryshuar me VKM-në nr.943 datë 28.12.2016 (shënim- përcaktoni aktin ligjor ose nënligjor specifik dhe nenin përkatës, që parashikon licencimin e subjekteve, në lidhje me veprimtarinë përkatëse për realizimin e shërbimeve objekt kontrate).

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjisllacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente. Pikat e licensës së kërkuar janë bazuar në shërbimet të cilat kërkohen të sigurohen nga autoritetit sipas parashikimeve të tij për investime të ndryshme të cilat i ka parashikuar për ti kryer. Të cilat kanë të bëjnë me punime civile në tinaele dhe diga, punime mekanike dhe elektrike, ndërtime të impianteve të energjisë së rinovueshme, ndërtime dhe rikonstruksione rrugësh dhe sheshesh, mbrojtje lumore dhe skarpatesh, punime rehabilitimi të kullave të marrjes, portave të punës, etj.

**2.3.3** Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar për periudhën Mars 2024 – Maj 2024 minimalisht 15 (pesëmbëdhjetë) punonjës nga të cilët minimalisht:

- ✚ 2 (dy) Inxhinierë Hidroteknike;
- ✚ 2 (dy) Inxhinierë Ndërtimi;
- ✚ 1 (një) Inxhinier Ndërtimi me profil Strukturist;
- ✚ 1 (një) Inxhinier Gjeodet;
- ✚ 1 (një) Inxhinier Gjeolog;
- ✚ 1 (një) Inxhinier Mekanik;
- ✚ 1 (një) Inxhinier Elektrik;
- ✚ 1 (një) Inxhinier Mjedisi;

***Në lidhje me kërkesën e mësipërme, gjatë ofertimit ofertuesi duhet të plotësojë në mënyrë të detajuar formularin përmbledhës të vetë deklaramit dhe më pas, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar i pari të paraqesë pranë Autoritetit Kontraktor, dokumentacionin i cili duhet të përputhet me atë të shprehur në formularin përmbledhës të vetë deklaramit si:***

- ✚ Kontratë pune të vlefshme;
- ✚ Diplomë;
- ✚ License individuale profesionale
- ✚ Listëpagesat e shoqërisë formulari E-sig, për periudhën Mars 2024 – Maj 2024

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Gjithashtu edhe në dhe nenit 41, pika 4/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. Konkretisht:

Inxhinierët e mëshipërm janë kërkuar bazuar në parashikimeve autoritetit për investime të ndryshme të cilat i ka parashikuar për ti kryer gjatë periudhës së zbatimit të kësaj kontrate. Të cilat kanë të bëjnë me punime civile në tinele dhe diga, punime mekanike dhe elektrike, ndërtime të impianteve të energjisë së rinovueshme, ndërtime dhe rikonstruksione rrugësh dhe sheshesh, mbrojtje lumore dhe skarpatesh, punime rehabilitimi të kullave të marrjes, portave të punës, etj.

**2.3.4** Operatori Ekonomik duhet të përmbledhë të dhenat për inxhinieret e kërkuar më sipër sipas tabelave në vijim:

POZICIONI	EMRI MBIEMRI I SPECIALISTIT TË PROPOZUAR PËR KËTË POZICION	DIPLOMA QË ZOTERON	EKSPERIENCA NË MBIQEQRJE (VITE)
Inxhinier Hidroteknik			
Inxhinier Hidroteknik			
Inxhinier Ndërtimi			
Inxhinier Ndërtimi			
Inxhinier Ndërtimi me profil Strukturist			
Inxhinier Gjeodet			
Inxhinier Gjeolog			
Inxhinier Mekanik			
Inxhinier Elektrik			
Inxhinier Mjedisi			

*Asnjë nga inxhinierët e mësipërm sipas tabelës, nuk duhet të jenë të angazhuar njëkohësisht në stafin e dy shoqërive që marrin pjesë në procedurën e prokurimit.*

*Në rastet e bashkimit të shoqërive deklarata e mësipërme duhet të firmoset nga të gjithë përfaqesuesit e autorizuar të shoqërive pjesëmarrëse në bashkim.*

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, në të cilin citohet: b) *një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës;*

**2.3.5** Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë Çertifikatat ISO ose ekuivalentet e tyre, në përputhje me objektin e prokurimit, të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, si më poshtë:

- a) ISO 9001 : 2015 “Sistemet e Menaxhimit të Cilësisë”
- b) ISO 14001: 2015 “Sistemi i Menaxhimit të Mjedisit”
- c) ISO 45001: 2018 “Sistemi i Menaxhimit të Shëndetit dhe Sigurisë në Punë”;

**ISO 9001:2015 “Sistemi i menaxhimit të cilësisë”** – Ky standard është i nevojshëm për certifikimin në realizimin e cilësisë, identifikimin e rrisqeve, caktimin e burimeve të nevojshme për të kontrolluar nëse shërbimet e ofruar janë të cilësisë së duhur si dhe kontrollin e proceseve.

**ISO 14001-2015 “Sistemi i menaxhimit të mjedisit”** është e nevojshme që Kontraktori të ketë staf të vetëdijshëm për politiken mjedisore dhe pasojat e mundshme të aktiviteteve të tyre në mjedis. Aktivitetet e kontraktorit duhet të jenë të tilla që të kontrollohet ndikimi në mjedis dhe të përgjigjet në rast emergjence të ndikimit në mjedis.

**ISO 45001:2018 “Sistemi i menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë”**, është i nevojshëm për ndërgjegjësimin e gjithë personelit të shoqërisë në lidhje me masat e mbrojtjes së shëndetit, sigurisë dhe konsultimit të punësuarve për vlerësimin e rrisqeve të shëndetit dhe sigurisë në punë.

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme janë vendosur bazuar në Nenin 79, pika 1 të Ligjit Nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar sipas të cilit: “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”, si dhe në zbatim të Nenit 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet,

*objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”*

*Çertifikatat e cilësisë janë bazuar në përputhje me objektin e shërbimit që do kryhet dhe janë në përputhje me natyrën dhe objektin e kontratës që prokurohet.*

## **II. Argumentimi i specifikimeve teknike**

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për shërbimet objekt prokurimi, që do të përfshihen në termat e referencës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar**, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.*

*Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.*

Termet e referencës janë përgatitur konform Ligjit Nr. 8402, Datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar.

Njësia e Prokurimit